

Formular për SYLLABUS të Lëndës: **Statistikë**

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Statistikë
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	E obligueshme
Viti i studimeve:	Viti i parë, Semestri i Dytë
Numri i orëve në javë:	2L+2U, L-ligjërata; U-Ushtrime
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësit e lëndës:	
Përshkrimi i lëndës	Lënda “Statistikë” përmban informata dhe njohuri të rëndësishme praktike dhe teorike dhe prezanton një pamje gjithëpërfshirëse të teknikave dhe metodave të ndryshme statistikore të rëndësishme për mbledhjen, grupimin dhe analizimin e të dhënave të ndryshme si: Kuptimi dhe elementet e analizës statistikore; Fazat e studimit statistikor; Vlerat mesatare të karakteristikës; Madhësitë mesatare të pozicionit; Variacioni / shpërndarja/ i karakteristikës, Treguesit relativ të variacionit; Numrat indeksor; Analiza dinamike/seritë kohore; Analiza e regresionit dhe korrelacionit, etj.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i modulit është të pajisë studentët me njohuri, aftësi dhe kompetenca në ndërmarrjen e tërë procesit të studimit statistikor.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që të: - Shpjegojnë kuptimin e statistikës, elementet e analizës statistikore, variablat kualitative dhe kuantitative si dhe mënyrat e vrojtimit statistikorë, - Përshkruajnë se si statistikat ndikojnë në jetën e tyre të përditshme dhe njohin rolin e statistikave në disiplina të ndryshme; - Përzgjedhin dhe ndërtojnë paraqitje grafike, tabelore dhe numerike për shpërndarjen e variablave për një grumbull të dhënash. - Llogarisin treguesit e ndryshëm të statistikave deskriptive dhe të bëjnë interpretimin e tyre. - Llogarisin dhe interpretojnë tregues të ndryshëm të analizës dinamike, si indekset parametrat e trendit linear, eksponencial, etj. - Analizojnë ndërvarësinë midis dy variablave, të studiojnë lidhjen që ekziston midis tyre duke u bazuar në modele të thjeshta, të analizojë lidhjet korrelative midis variablave, etj. - Analizojnë dhe debatojnë argumente statistikore, të tilla si ato të gjetura në shtypin ditor dhe publikimet shkencore.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	2	5	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1	6
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume, seminare	-	-	-
Detyra të shtëpisë	2	10	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgaditja përfundimtare për provim	-	-	16
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuize,provim final).	3	3	9
Projektet, prezantimet ,etj	-	-	4
Totali			150
Metodologjia e mësimëdhënies:			
	Metoda e punës gjatë tri orëve ligjërata do të përqendrohet në ligjërata dhe diskutime interaktive me pjesëmarrje të studentëve në procesin e mësimin, me prezantime individuale e grupe, të punimeve të ndryshme të përgatitura nga studentët. Studentët inkurajohen që paraprakisht të hulumtojnë dhe lexojnë materiale rreth temave vijuese, në mënyrë që të jenë më të përgatitur në orë të mësimin për të zhvilluar diskutime interaktive në mes të tyre me qëllim të përvetësimit më të shpejtë dhe më të thellë të çështjeve të rëndësishme të statistikës. Konceptet e mësuara gjatë orëve të ligjëratave do të praktikohen përmes shembujve konkret gjatë orëve të ushtrimeve, e kohë pas kohe do të ketë demonstrime të rezultateve të hulumtimit në SPSS.		
-			
Metodat e vlerësimit:	▪ Pjesëmarrja aktive - 5% ▪ Detyrat e shtëpisë – 10% ▪ Seminar praktik duke përdorë të dhëna- 10% ▪ Kollokviumi i parë – 10% ▪ Kollokviumi i dytë - 10% ▪ Provimi përfundimtar - 55% Kriteret e dhënies së provimit janë të bazuara në Vendimin e Këshillit të Fakultetit të prezantuar në Raportin e Vetëvlerësimit.		
Literatura			
Literatura bazë:	Rahmije Mustafa Topxhiu: (2016) <i>HYRJE NË STATISTIKË</i> , Prishtinë		
Literatura shtesë:	1. Prem S. Man, (2010) <i>Introductory Statistics</i> , Seventh		

	Edition, John Wiley & Sons, USA, 2. Douglas A. Lind. William G. Marchal, Samuel A. Wathen, (2013), <i>Basic Statistics for Business & Economics</i>, Eighth Edition, McGraw-Hill/Irwin, International Edition, New York. 3. David R. Anderson, Dennis J. Sweeney, Thomas A. Williams, (2013), <i>Statistika për biznes dhe ekonomik</i>, UET press, Tiranë. 4. Ajet Ahmeti, Statistikë për biznes dhe ekonomiks, 2016	
Plani i dizajnuar i mësimi:		
Java	Ligjërata që do të zhvillohet (Libri: <i>HYRJE NË STATISTIKË</i>)	Faqe
Java e 1 ^{-re}	HYRJE - Prezantimi i lëndës, - Metodatat e punës dhe vlerësimit; - Obligimet e dyanshme student-mësimdhënës.	
Java e 2 ^{-te}	KAPITULLI 1: KUPTIMI DHE RËNDËSIA E STATISTIKËS 1.2 Çfarë kuptojmë me Statistikë? 1.3 Llojet e Statistikës 1.4 Konceptet kyçe në analizën statistikore 1.5 Të dhënat statistikore 1.6 Grumbullimi i të dhënave dhe Burimet e të dhënave statistikore 1.7 Pak histori për statistikën 1.8 Përdorimi i kompjuterëve në statistikë	19-61
Java e 3 ^{-te}	KAPITULLI 2: PËRMBLEDHJA DHE GRUPIMI I TË DHËNAVE STATISTIKORE - SHPËRNDARJA E FREKUENCAVE DHE PARAQITJET GRAFIKE 2.2 Përmbledhja dhe grupimi i të dhënave statistikore 2.3 Organizimi (grupimi) dhe prezantimi grafik i të dhënave kualitative (cilësore) 2.4 Organizimi (grupimi) dhe prezantimi grafik i të dhënave numerike (sasore)	67-98
Java e 4 ^{-te}	KAPITULLI 2: PËRMBLEDHJA DHE GRUPIMI I TË DHËNAVE STATISTIKORE - SHPËRNDARJA E FREKUENCAVE DHE PARAQITJET GRAFIKE 2.5 Disa paraqitje të tjera grafike të të dhënave 2.6 Tabelat e kryqëzuara	98-110
Java e 5 ^{-te}	KAPITULLI 3: MATËSIT E TENDENCËS QENDRORE - MADHËSITË MESATARE 3.2 Madhësitë mesatare- kuptimi 3.3 Mesatarja aritmetike për të dhënat e pa grupuara 3.4 Mesatarja aritmetike për të dhënat e grupuara/e ponderuar	121-133
Java e 6 ^{-te}	KAPITULLI 3: MATËSIT E TENDENCËS QENDRORE - MADHËSITË MESATARE	133-142 144-152

	3.5 Mediana (vlera e mesit) 3.6 Moda (vlera dominuese) 3.7 Lidhjet në mes të mesatares aritmetike, medianës dhe modës	
<i>Java e 7^{te}</i>	KAPITULLI 4: TREGUESIT E VARIACIONIT DHE TREGUES TË TJERË TË PËRSHKRIMIT TË TË DHËNAVE 4.2 Pse duhet të studiohet variacioni apo shpërndarja ? 4.3 Treguesit e variacionit për të dhënat e pagrupuara 4.4 Treguesit e variacionit për të dhënat e grupuara	153-168
<i>Java e 8^{te}</i>	KAPITULLI 4: TREGUESIT E VARIACIONIT DHE TREGUES TË TJERË TË PËRSHKRIMIT TË TË DHËNAVE 4.5 Çështje të tjera që lidhen me variacionin e të dhënave 4.6 Tregues të tjerë të pozicionit dhe të shpërndarjes së të dhënave statistikore 4.6 Përdorimi i “Statistikave përshkruese” në Excel	169-195
<i>Java e 9^{te}</i>	KOLLOKVIUMI I PARË	
<i>Java e 10^{te}</i>	KAPITULLI 13: NUMRAT INDEKSORË 13.2 Kuptimi i indekseve 13.3 Indekset individuale (të thjeshta) 13.4 Indekset individuale dhe agregate të çmimeve	559-578
<i>Java e 11^{te}</i>	KAPITULLI 13: NUMRAT INDEKSORË 13.5 Indekset agregate të ponderuara të sasisë dhe indeksi i vlerës (shpenzimeve) 13.6 Disa forma të veçanta të indekseve agregate dhe aplikim i tyre 13.7 Norma mesatare e ndryshimit- mesatarja gjeometrike e indekseve vargorë	578-597
<i>Java e 12^{te}</i>	KAPITULLI 12: ANALIZA E REGRESIONIT DHE KORRELACIONIT TË THJESHTË LINEAR 12.2 Lidhja funksionale dhe rastësore (stohastike) 12.3 Modeli i regresionit të thjeshtë linear 12.4 Vlerësimi i modelit të regresionit: Metoda e katrorëve më të vegjël	497-520
<i>Java e 13^{te}</i>	KAPITULLI 12: ANALIZA E REGRESIONIT DHE KORRELACIONIT TË THJESHTË LINEAR 12.6 Analiza e korrelacionit të thjeshtë linear	521-526 549-558
<i>Java e 14^{te}</i>	KAPITULLI 14: HYRJE NË ANALIZËN E SERIVE KOHORE 14.2 Përbërësit e serive kohore 14.3 Vlerësimi i prirjes dhe parashikimit me metodën e trendit linear.	597-625
<i>Java e 15^{te}</i>	KOLLOKVIUMI I DYTË	

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive në ligjëratat dhe në ushtrime;
- Respektimi i orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve.
- Ç’kyçja e telefonave celular dhe mbajtja e qetësisë në mësim.